



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 586 Prot.

Tiranë, më datë 14.04.2020

VENDIM

Nr. 112, datë 14.04.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit dhe raportit të vëzhgimit arkeologjik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.04.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës Ismail Qemali, Rehabilitimi i Kanalit Kullues KK1, segmenti D1, sistemim asfaltim i rrugës turistike të fshatit Qerret me kanalin kullues KK1, rruga e re e fshatrave turistike Nj. V. Golem, Kavajë”, me zhvillues Bashkia Kavajë, dhe raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga subjekti i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani;
 2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
 3. Subjekti Bashkia Kavajë duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e sipërcituar, si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt.
 4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
1. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

